

NEKROLOGJI

Idriz Metani (1956-2024)

Para pak muajsh u largua para kohe nga jeta, prof. as. dr. Idriz Metani. Ai lindi në vitin 1956, në Skrapar. Kreu shkollën e mesme e pedagogjike në Fier, si dhe studimet e larta me rezultate shumë të mira për gjuhë shqipe e letërsi në Institutin e Lartë Pedagogjik të Elbasanit (sot Universiteti “Aleksandër Xhuvani”). Pas mbarimit të tyre, në vitin 1980 fillon punë si mësues në Skrapar duke punuar në disa shkolla të ndryshme, si në shkollën “Skënder Xhemali”, në shkollën “Kahreman Ylli”, në shkollën “Refat Keli” dhe në Shkollën “Zylyftar Veleshnja” duke u spikatur si mësues i dalluar, me pasion e me përkushtim në procesin mësimdhënie e atë edukues. Njëherazi ai dallon dhe për aftësi metodike, organizuese e drejtuese. Këto e mundësuan që ai të punonte si metodist në Kabinetin Pedagogjik të Skraparit nga viti 1986-1993, si përgjegjës i Zyrës arsimore në Bashkinë e qytetit të Çorovodës, Skrapar (1995-1997) dhe si specialist i gjuhës shqipe dhe i letërsisë pranë Drejtorisë Arsimore të rrethit të Skraparit.

Por Idriz Metani kishte interesa shumë më të mëdha e më të gjera se ato të punës si mësues. Ai, si pedagogjikas dhe si student i gjuhës e i letërsisë, kishte një formim shumë të mirë gjuhësor dhe hyri me kurajë dhe me guxim në rrugën e kualifikimit shkencor të atij pasuniversitar dhe të studimeve të thelluara në fushën e gjuhësisë. Në vitin akademik 1983 - 1984 ndjek kursin pasuniversitar të gjuhës shqipe, departamenti i gjuhës shqipe, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Universiteti i Tiranës, të cilin e mbaron me rezultate shumë të larta.

Pasi kthehet në Skrapar fillon dhe me merret me grumbullimin e pasurisë gjuhësore të zonës së Skraparit, sidomos të pasurisë leksikore e asaj dialektologjike. Krahas mësimdhënies Idriz Metani dha provimet pasuniversitare kualifikuese për të fituar gradën shkencore “Doktor i shkencave gjuhësore”, gradë të cilën e mbrojti në vitin 1997.

Kjo e mundësoi që puna tij si specialist të ngrihej në një shkallë të lartë. Në vitin 1998 – 2002 punon si specialist i gjuhës shqipe në Drejtorinë arsimore të qytetit të Tiranës dhe pedagog i jashtëm në Departamentin e gjuhësisë, pranë Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë të Universitetit të Tiranës, në vitet 2002-2003 punon dhe si pedagog i jashtëm në Departamentin e gjuhësisë pranë

Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë të Universitetit të Tiranës, por edhe si specialist në Degën mësimore të Rektoratit të Universitetit të Tiranës. Kurse në vitin 2003 e deri në vitin 2023 ai punon si pedagog i brendshëm pranë këtij Departamenti.

Idriz Metani në vitin 2009 fiton titullin “Profesor i asociuar”. Ai zotëronte tri gjuhë të huaja (frëngjisht, rusisht dhe italisht) dhe dalloj për një veprimtari të dendur shkencore, përmes kumtimeve në konferenca të ndryshme kombëtare e ndërkombëtare, brenda dhe jashtë vendit si dhe për mes botimeve shkencore me prurje të vlerësueshme në fushën e albanologjisë e të pedagogjisë.

Ai boton monografinë *Semantika leksikore e emërtimeve të njerëzve sipas tipareve fizike e morale në gjuhën shqipe*, 2019, tri përmbledhje me artikuj shkencorë *Gjurmime për semantikën leksikore në gjuhën shqipe, I, II, III*, Tiranë, 2020, 2023; veprën e vëllimshme me 15.000 fjalë *Fjalor i emërtimeve të njerëzve sipas tipareve fizike e morale në gjuhën shqipe*, 2023.

Ai boton 30 artikuj në revista shkencore brenda vendit, 40 artikuj në revista shkencore jashtë vendit, është bashkautor në 24 tekste për arsimin parauniversitar në vendin tonë.

Përveç punës si mësimdhënës akademik universitar, prof. as. dr. Idriz Metani ka punuar dhe si drejtues i përgatitjes shkencore të punimeve të shumë studentëve në të tri ciklet e studimeve universitare e ato të thelluara nga fusha e gjuhësisë, duke udhëhequr 5 doktorata, 60 mastera shkencorë, 50 mastera profesionalë dhe mbi 100 punime diplomash në nivel bachelor.

Idriz Metani ka qenë bashkëpunëtor i jashtëm i Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë për Aksionin Kombëtar të mbledhjes së fjalëve e të shprehjeve popullore dhe për Atlasin Dialektologjik të Gjuhës Shqipe (nga viti 1984 e në vazhdim); bashkëpunëtor i jashtëm i Institutit të Studimeve Pedagogjike; anëtar i grupit të punës të Ministrisë së Arsimit për kontrollin e kualifikimin e mësuesve të gjuhës shqipe (1985 e në vazhdim); anëtar i grupit të punës të Ministrisë së Arsimit për kontrollin e kualifikimin e mësuesve të gjuhës shqipe (1985-1990); anëtar i redaksisë së revistës “Kurrikula dhe shkolla”, botim i Institutit të Studimeve Pedagogjike (2002); anëtar i grupit të punës për gjuhën shqipe në shkollë, ngritur nga Këshilli Ndërkademi për Gjuhën Shqipe (2005); anëtar i Këshillit Shkencor të Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë, Universiteti i Tiranës (2008 e në vazhdim); anëtar i Këshillit Drejtues të Seminarit Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Prishtinë (2018), bashkëhartues i Fjalorit të Madh të Gjuhës Shqipe, projekt i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Idriz Metani ka qenë pjesëmarrës në shumë projekte të tjera shkencore, si bashkëpunëtor i jashtëm i Institutit të Studimeve Pedagogjike për vëzhgimin dhe pilotimin e teksteve të gjuhës shqipe në arsimin parauniversitar; bashkëpunëtor në projektin kombëtar “Izoglosa të morfeve të kafshëve në Shqipëri”, financuar nga Rektori i Universitetit të Tiranës; bashkëpunëtor në

projektin “Studime sociolinguistike për të folmen e Tiranës”, financuar nga Rektorati i Universitetit të Tiranës; bashkëpunëtor në projektin “Studime sociolinguistike për të folmet e Shqipërisë së Mesme”, financuar nga Rektorati i Universitetit të Tiranës” bashkëpunëtor në projektin “Studime sociolinguistike për të folmet e Shqipërisë Juglindore etj.

Me largimin e prof. Idriz Metani nga jeta, albanologjia dhe shkolla shqiptare humbi një studiues, një pedagog, një metodist e një mësues me veprimtari të gjatë dhe cilësore. Ne humbëm një koleg e mik të nderuar, një njeri të suksesit pedagogjik e shkencor; familja dhe të afërmit njeriun e tyre të shtrenjtë e të pazëvendësueshëm.

Valter MEMISHA

